

VENDIM
Nr. 428, datë 8.6.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR HARTËN
DIXHITALE TË VENDDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE URBANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane (shkurtimisht “HDVMU”).

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr. 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

3. Sistemi i bazës së të dhënave të hartës dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane realizohet në përputhje me standardet e parashikuara në ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, dhe përmban të dhëna, për:

- a) llojin e venddepozitimit;
- b) popullsinë së cilës i shërben ky venddepozitim;
- c) sasinë e mbetjeve të depozituara në vit;
- ç) distancat nga:
 - i) vendbanimet;
 - ii) rrugët nacionale;
 - iii) brigjet ujore;
 - iv) burimet ujore;
 - v) aeroportet;
 - vi) shtëpitë;
 - vii) hekurudhat;
 - viii) varrezat;
 - ix) qendrat e qytetit.
- d) fotografitë e venddepozitimit dhe të zonës përreth;
- dh) dokumente të planifikimit;
- e) të dhëna hapësinore/hartografike në lidhje me rajonin e mbetjeve dhe bashkitë ku ndodhet venddepozitimi.

4. Institucioni administrues i sistemit të hartës dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane është Ministria e Zhvillimit Urban nëpërmjet strukturës përkatëse që mbulon çështjet e HDVMU-së.

5. Të dhënat parësore dhe dytësore të hartës janë, si më poshtë vijon:

5.1 Të dhënat parësore përfshijnë:

- a) shtrirjen fizike të venddepozitimit në territor;
- b) sipërfaqen e venddepozitimit;
- c) distancat nga zona me interes të veçantë;
- ç) foto të venddepozitimit, si dhe të zonës përreth;
- d) pikat në hartë.

5.2 Të dhënat dytësore përfshijnë:

a) hartat dhe ortofotot për të gjithë territorin e Shqipërisë;

b) rrugët nacionale;

c) linjat hekurudhore;

ç) kufijtë administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore (NVQV);

d) dokumentet e planifikimit të vëna në dispozicion nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore përkatëse;

dh) sasitë e mbetjeve të depozituara në venddepozitim;

e) numrin e popullsisë të cilës i shërben venddepozitimi ekzistues.

6. Dhënësit e informacionit për hartën janë përdoruesit e thjeshtë, sipas rolit që kryejnë në hartë, si:

a) Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, dhe Gjeoportali Kombëtar ASIG, në nivel kombëtar;

b) organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në nivel vendor.

6.1 Informacioni i dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit përfshin:

a) caktimin e pikave të venddepozitimeve në hartë;

b) përcaktimin e sipërfaqeve të venddepozitimeve në hartë;

c) reflektimin e zhvillimeve të reja bazuar në planet kombëtare.

6.2 Informacioni i dhënë nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet shkresave zyrtare dhe vizitave në terren përfshin:

a) numrin e popullsisë;

b) dokumente planifikimi;

c) të dhëna statistikore dhe historike mbi mbetjet.

6.3 Informacioni i dhënë nga Gjeoportali Kombëtar ASIG, përfshin:

a) informacion mbi kufijtë territorialë;

b) harta dhe ortofoto.

7. Baza e të dhënave e hartës dixhitale shkëmben informacion, nëpërmjet shërbimeve *on-line* të kërkimit, shikimit, shkarkimit dhe transformimit me sistemin e Gjeoportalit Kombëtar të ASIG-ut, sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

8. Subjektet e interesuara kanë mundësi të marrin informacionin e afishuar në hartë dhe të bëjnë komente mbi të, por jo të kryejnë përditësime.

9. Baza e të dhënave e hartës dixhitale ka dy nivele përdoruesish:

a) administrator;

b) përdorues.

10. Subjektet e interesuara për hartën dixhitale, janë:

a) qytetarët, për qëllime informimi;

b) zhvilluesit dhe investitorë, për qëllime informimi e investimi;

c) organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, për qëllime informimi e planifikimi;

ç) institucionet qendrore, për qëllime informimi e planifikimi.

11. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi